

V E N D I M
Nr.5, datë 15.4.1994

Gjykata Kushtetues e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese	
Feti Gjilani	zv.kryetar	i	""
Hilmi Dakli,	Anëtar	i	""
Franc Jakova,	Anëtar	i	""
Veli Budo,	Anëtar	i	""
Ylvi Myrtja,	Anëtar	i	""
Thimjo Kondi,	Anëtar	i	""

në mungesë të anëtarëve Manol Konomi e Natasha Sheshi për shkaqe objektive, me sekretare Drita Filto, më datën 11.4.1994, 15.4.1994, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S : GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE, i përfaqësuar nga Elmaz Sherifi, Luan Shahollari e Vladimir Metani.

O B J E K T I:

Garantimi dhe respektimi i së drejtës për tubim paqësor në vendet dhe sheshet e kalimit publik.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Në kërkesën datë 28.2.1994 Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste të Shqipërisë parashtroi disa raste që Komiteti Drejtues i Partisë Socialiste të Tiranës ka kërkuar nga organet e rendit publik leje për organizimin e tubimeve paqësore në sheshe dhe vende të kalimit publik, në pajtim me kërkesat e dekretit nr.7408, datë 31.7.1990 "Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vendet publike", dhe pretendon se refuzimet e tyre janë të paligjshme e, si të tilla, përbëjnë shkelje të së drejtës për organizimin e tubimeve, të parashikuar në nenin 21 të ligjit kushtetues "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Përsa parashtroi Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, Gjykata Kushtetuese çmon se asaj në fakt i janë paraqitur për shqyrtim disa çështje konkrete të bashkuara në një kërkesë të vetme, të cilat, ndonëse kanë të njëjtin objekt dhe u referohen rrethanave të përafërta, gjithësesi kanë individualitetin e tyre. Në secilën çështje vihen përballë dy palë: Nga njëra anë, persona që i bashkon anëtarësia në Partinë Socialiste, apo simpatia për këtë forcë politike, dhe qëllimi për të demonstruar mospajtimin me veprimtarinë e organizmave të caktuara publike dhe, nga ana tjetër, organet shtetërore të mbrojtjes së rendit publik.

Shkaku dhe objekti i secilit nga këto kërkitime është e drejtë themelore për organizimin e tubimeve paqësore në pajtim me kërkesat e dekretit përkatës dhe gjendja e pretenduar e faktit që i kundërvihet kësaj të drejte. Si rrjedhim, kërkohet që, në përfundim të gjykimit, të vendoset njohja e së drejtës së manifestuesve, të vihen në vend shkeljet e pretenduara dhe të garantohet respektimi i së drejtës në të ardhmen nëpërmjet një vendimi detyrues të Gjykatës Kushtetuese.

1. Përsa i përket juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për zgjidhjen e çështjes, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste i referohet nenit 24, pika 9 të Ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 (Organizimi i Drejtësisë dhe Gjykata Kushtetuese), sipas të cilit, "Gjykata Kushtetuese... zgjidh përfundimisht ankesat e personave të paraqitura në rrugën e kontrollit kushtetues për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme".

Gjykata Kushtetuese çmon se kjo zgjedhje e juridiksionit është e gabuar, për këto arsye:

Nuk ka dyshim se e drejta për tubim është një e drejtë themelore, e cila nuk mund të mohohet. Ajo mund të kufizohet vetëm në raste përjashtimore e të veçanta të përcaktuara shprehimisht me ligj, brenda caqeve që lejon dispozita kushtetuese përkatëse (neni 21/2 i cili ka tekstualisht këtë përmbajtje:

"Tubimet në sheshet dhe vendet e kalimit publik bëhen me lejen paraprake të organit

kompetent, i cili mund të mos i lejojë vetëm për shkaqe të bazuara që rrezikojnë seriozisht rendin dhe sigurimin publik”.

Nga ana tjetër në nenin 39 të ligjit kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, është përcaktuar se: “Askujt, të cilit i është cenuar një e drejtë e njohur në këtë ligj kushtetues, nuk mund t’i mohohet rivendosja e së drejtës në gjykatë”. Pra, edhe e drejta njerëzore kolektive për t’u mbledhur në tubime paqësore e pa armë, në qoftë se mohohet apo kufizohet nga organet kompetente për ruajtjen e rendit publik, pa shkaqe të përligjura, mund të mbrohet e të rivendoset në rrugë gjyqësore. Pika 9 e nenit 24 të Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese në mënyrë të shprehur parashikon se kjo gjykatë zgjidh përfundimisht ankesat e personave për shkeljen e të drejtave të tyre themelore nga aktet e paligjshme. Prej kësaj rezulton në mënyrë të qartë e pa ekuivoke se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për këtë kategori çështjesh konkrete, nuk është juridiksion fillestar. Kjo do të thotë se Gjykata Kushtetuese mund të investohet për një shkelje të të drejtave kushtetuese, vetëm pasi shqyrtimi i saj të ketë përfunduar në të gjitha organet e tjera shtetërore të përcaktuara me ligj, si dhe në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të të gjitha shkallëve.

2. Në çështjen në shqyrtim lind edhe problemi i legjitimitetit të Grupeve Parlamentare për ngritjen e kërkesave të tilla në Gjykatën Kushtetuese. Është e vërtetë se në nenin 25/II të Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese, përmenden në mënyrë të shprehur e taksative subjektet që legjitimohen për ta vënë në lëvizje këtë gjykatë, pa u specifikuar rastet konkrete për secilin subjekt, por kjo nuk do të nënkuptonte që secili prej tyre kur e çmon të nevojshme, mund të iniciojë pa asnjë kufizim çdonjërin prej gjykimeve në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, të grupuar si gjykime kushtetuese abstrakte, konkrete dhe incidentale.

Duke u nisur nga një bazë e arsyeshme, Gjykata Kushtetuese konkludon se legjitimiteti i secilit subjekt duhet të përcaktohet duke u nisur nga lloji i çështjes kushtetuese dhe nga lidhja që ka me të subjekti përkatës.

Si rrjedhim, siç del në mënyrë të shprehur edhe në nenin 8 të Ligjit Kushtetues “Për organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese”, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm mund ta investojnë Gjykatën Kushtetuese vetëm në një rast. Ato kanë të drejtë të pezullojnë çështjen dhe t’ia dërgojnë atë Gjykatës Kushtetuese, kur arrijnë në përfundimin se ligji që i referohet çështja konkrete është antikushtetues (respektivisht, akti nënligjor normativ është i paligjshëm dhe antikushtetues).

Duke iu referuar çështjes objekt shqyrtimi, arrijmë në përfundimin se një Grup Parlamentar ose një grup deputetësh prej 1/5 së numrit të përgjithshëm të tyre, duke u nisur nga përkatësia e tyre në përbërje të organit ligjvënës, dhe nga funksionet e tyre, kanë të drejtë të iniciojnë në Gjykatën Kushtetuese një gjykim abstrakt për interpretim të dispozitave kushtetuese e për të deklaruar se një akt normativ është antikushtetues, por jo një gjykim konkret për të cilin legjitimohen subjekte të tjerë.

Çështja e paraqitur për gjykim në pikëpamje juridike i përket ekskluzivisht një grupimi politik individësh të bashkuar organizativisht në strukturat e një partie dhe për ta Grupi Parlamentar nuk ka e nuk mund të ketë ndonjë mandat përfaqësimi ligjor. I shikuar problemi më gjerë, deputetët e kandiduar nga një parti e caktuar e që bëjnë pjesë në grupin parlamentar të saj, marrin pjesë në mënyrë të natyrshme në veprimtaritë politike të partisë jashtë parlamentit, por vetë grupi parlamentar, si i tillë, de jure është organizuar dhe funksionon vetëm në kuadrin e procedurave parlamentare e në procesin ligjvënës. Derivat i kësaj veprimtarie është edhe e drejta që i njihet atij për të atakuar në Gjykatën Kushtetuese ligjet (normat) që çmon se nuk pajtohen me dispozitat kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 dhe 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës për mungesë juridiksioni të Gjykatës Kushtetuese dhe për mungesë legjitimiteti të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Vendimi është i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e komunikimit Grupit Parlamentar.

Votuan pro këtij vendimi: Rustem Gjata, Feti Gjilani, Hilmi Dakli, Franc Jakova e Thimjo

Kondi.

Votuan kundër: Veli Budo e Ylvi Myrtja, me këtë arsytim:

MENDIMI I PAKICËS

Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese Veli Budo e Ylvi Myrtja, duke mos u pajtuar me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga shumica parashtrojnë mendimet e tyre si më poshtë:

Nga shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, rezulton se në disa rrethe të Shqipërisë, Komitetet Drejtuese të kësaj partie në mënyrë të përsëritur kanë kërkuar nga organet e rendit publik leje për organizimin e tubimeve paqësore në sheshe dhe vende publike, në pajtim me kërkesat e dekretit nr.7408, datë 31.7.1990 “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vendet publike”, të cilat janë refuzuar.

Kundër këtyre refuzimeve kërkuar janë ankuar edhe tek Ministri i Rendit Publik nga i cili kanë marrë përgjigje negative. Pas shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Ministri i Rendit Publik dhe meqenëse në dekretin nr.7408, datë 31.7.1990 “Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet e shtetasve në vendet publike” nuk parashikohet e drejta e ankimit, organi që shqyrton ankimin dhe mënyra e shqyrtimit të ankesës, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste duke e konsideruar të konsumuar të drejtën e ankimit në rrugën e zakonshme administrative dhe në pamundësi për të kërkuar rivendosjen e të drejtës së shkelur të pretenduar nga komitetet drejtuese të Partisë Socialiste në rrethe në rrugën e zakonshme gjyqësore i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për “Garantimin dhe respektimin e të drejtës kushtetuese për tubim paqësor në vende dhe sheshe të kalimit publik”.

Në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate, Grupi Parlamentar pretendon se refuzimet e bëra nga organet e rendit publik kanë qenë të paligjshme dhe në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit Kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”.

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste legjitimohet proceduralisht në paraqitjen e kësaj kërkesë për shqyrtimin e kësaj çështjeje jo vetëm sepse në bazë të nenit 25 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, çdo grup parlamentar është një ndër subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë në mënyrë të pakufizuar fillimin e procedurës përkatëse në Gjykatën Kushtetuese, por edhe sepse nga grupi parlamentar i Partisë Socialiste kërkohet konkretisht garantimi dhe respektimi i së drejtës për tubime paqësore në vendet dhe sheshe publike të sanksionuar shprehimisht në këto dispozita (neni 21).

Në funksion direkt të objektit të shprehur Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste kërkon të bëhet interpretimi zyrtar i nenit 21 të Ligjit Kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” (neni 24 pika 1). Pikërisht nga ky interpretim zyrtar, që është një kompetencë themelore e funksionale e Gjykatës Kushtetuese, do të përcaktohet si rrjedhojë e natyrshme nëse është shkelur ose jo një e drejtë e mbrojtur nga Ligji Kushtetues (neni 24 pika 10/2).

Këtë qëndrim Gjykata Kushtetuese e ka mbajtur në një sërë vendimesh të mëparshme si psh, në vendimin nr.3, datë 13.7.1992 “Për anulimin e zgjedhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë; nr.10, datë 10.8.1993 “Për deklarimin antikushtetues të Vendimit të datës 30.7.1993 të prokurorit të rrethit Tiranë për arsyetimin e deputetit Fatos Nano”; nr.2, datë 25.2.1994 “Për pyetjen e Prokurorit të Përgjithshëm nga deputetët”, e raste të tjera. Deri më sot nuk është shtruar ende problemi i ndryshimit të këtij precedenti.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm, jemi të mendimit se Grupi Parlamentar legjitimohet në paraqitjen e kërkesës dhe Gjykata Kushtetuese është kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje. Shumica, duke rrëzuar kërkesën për mungesë të juridiksionit dhe legjitimitetit ka vepruar në kundërshtim me pikat 1,9, 10/2 të nenit 24 dhe 25/2 të ligjit nr.7561 datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Tiranë, më 15.4.1994